

POLICIA E SHTETIT



M A N U A L

(KUJTESË)

**PËR DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E
POLICISË SË SHTETIT**

NË PROCESET ZGJEDHORE

TIRANË, 2013

FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TE POLICISË SE SHQIPTARË

I nderuar koleg!

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë më 23 Qershor 2013 janë një ngjarje shumë e rëndësishme politike dhe sociale për vendin tonë. Ato, vlerësohen dhe kanë vëmendjen e të gjithë opinionit publik shqiptarë dhe faktorit ndërkombëtar.

Puna juaj si punonjës të policisë është e një rëndësie madhore për krijimin e një mjedisi të sigurtë për zgjedhje të lira e të ndershme, për ruajtjen e rendit publik dhe hetimin e veprave penale. Ndaj besimi se Policia vepron në mbështetje dhe mbrojtje të të drejtave të qytetarëve, është kusht dhe garanci që qytetarët ta ushtrojnë të drejtën e tyre themelore për të votuar dhe të drejtën për siguri dhe liri të shprehjes.

Policia e Shtetit në zbatim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë ka për detyrë që jo vetëm të garantojë rend e qetësi gjatë gjithë procesit si para, gjatë dhe pas zgjedhor, por edhe të paraqesë me dinjitet vlerat e saj si garantuese e zbatimit dhe respektimit të ligjit.

Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë, ndaj që një shtet demokratik të zhvillohet dhe lulëzojë, ai duhet të respektojë parimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, ku qytetari ka të drejtë dhe mundësi të votojë në përputhje me ligjin dhe të ketë sigurinë e votës së fshehtë dhe të numërimit të votave me efektshmëri dhe saktësi.

Sa më lart, është detyra juaj dhe pritshmëria themelore e qytetarëve që ju të punoni për të siguruar zbatimin e ligjit, Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit të KQZ-së. Parimi i shtetit të se drejtës, se *"Askush nuk mund të dalë mbi ligjin"* është shprehja konkrete e etikes profesionale të çdo punonjësi të Policisë së Shtetit, ndaj me përgjegjësitë e veçanta që ligji dhe Kodi Zgjedhor ju ngarkon, gjatë kryerjes së detyrave, në çdo rast të manifestoni, standarde të larta profesionale, etikë dhe integritet në zbatimin me përpikëri të ligjit.

Policia është e depolitizuar dhe detyrat i kryen në përputhje me ligjin. Kurrë mos e harro se *"Punonjësi i Policisë ka për detyrë të ushtrojë funksionet e veta në mënyrë të paanshme dhe pavarësisht bindjeve të tij politike."*

Ju sot jeni të gjithë të arsimuar e të mirë trajnuar, dhe kjo është një ndër arritjet e mëdha të organizatës së Policisë së Shtetit por, për përmbushjen e detyrave gjatë procesit zgjedhor, ju do të kryeni trajnime shtesë, për të cilat kërkoj që, jo vetëm

t'i kryeni me seriozitetin e duhur por dhe t'i zbatoni me korrektësi e përpikëri në praktikë.

Për t'ju ardhur në ndihmë gjatë ushtrimit të përgjegjësive tuaja në funksion të zhvillimit normal të zgjedhjeve të përgjithshme, ju vëmë në dispozicion këtë broshurë e cila siguron informacion të vlefshëm të cilin ju duhet ta njihni dhe zbatoni ndërsa u afrohemi zgjedhjeve të 23 Qershorit 2013.

Në aktivitete dhe ngjarje kaq të mëdha për vendin tonë ne nuk kemi qenë kurrë vetëm por me partnerë që na kanë mbështetur, asistuar e monitoruar punën dhe veprimtarinë e Policisë së Shtetit. Ju siguroj se këtë mbështetje e inkurajim të institucioneve shtetërore dhe misioneve ndërkombëtare, do ta kemi në vazhdimësi si në dhënien e trajnimit dhe materialeve të referimit, ashtu dhe në orientimin tuaj në marrjen e vendimeve.

Paraprakisht, pranoni falënderimet e mia personale për punën e lodhshme, përkushtimin dhe profesionalizmin që ju demonstroi ndaj kësaj detyre shumë të rëndësishme që ligji ju ngarkon e që qytetarët e Republikës kanë besim të plotë së do ta përbushni me sukses.

Koleg i nderuar,

Të gjithë së bashku jemi ndier krenarë për vlerësimet e shkëlqyera që janë bërë punës dhe veprimtarisë së Policisë së Shtetit para, gjatë dhe pas proceseve zgjedhore të viteve 2005, 2007, 2009 dhe 2011, të shprehura në raportet e strukturave të specializuara ndërkombëtare që monitorojnë zgjedhjet, partnerët tanë që asistojnë Policinë e Shtetit.

Le të konfirmojmë përsëri, të gjithë së bashku, se Policia e Shtetit do të jetë pararojë dhe promotor i vlerave më të mira të një shoqërie demokratike.

Nga vota e lirë rrjedhin të gjithë pushtetet! E drejta e votës është e shenjtë. Ndaj , Ju të gjithë duhet të jeni krenare dhe të privilegjuar që ligji u ngarkon me detyrën fisnike të ruajtjes dhe garantimit të kësaj të drejte.

Duke ju uruar suksese në këtë mision të rëndësishëm,

Hysni BURGAJ

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit



K U J T E S Ë

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POLICISË SË SHTETIT NË PROCESIN ZGJEDHOR

Në zbatim të akteve ligjore që ngarkojnë me detyra Policinë e Shtetit gjatë proceseve zgjedhore dhe në funksion të përmbushjes me sukses të këtyre detyrave institucionale është përgatitur ky material në formë kujtese për të gjithë punonjësit e policisë.

Misioni i Policisë së Shtetit është të ruaj rendin dhe sigurinë publike në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat e liritë e njeriut.

Në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë parashikohet se rendi dhe siguria gjatë periudhës zgjedhore ruhet nga Policia e Shtetit.

Në këtë Kujtesë trajtohen:

1. Kujtesë për detyrat e Policisë së Shtetit gjatë zhvillimit të fushatave elektorale.

2. Kujtesë për detyrat e Policisë së Shtetit për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve zgjedhore dhe shoqërimin e materialeve të votimit.
3. Kujtesë për detyrat e Policisë së Shtetit për hetimin dhe dokumentimin e veprave penale.
4. Modularë aktesh.

I. KUJTESË PËR DETYRAT E POLICISË SË SHTESTIT GJATË ZHVILLIMIT TË FUSHTATËS ELEKTORALE.

**I nderuar koleg,
kujtohu dhe mos harro!**

Se:

- Strukturat e Policisë gjatë përmbushjes së përgjegjësive institucionale, duhet të marrin të gjitha masat për garantimin e rendit publik gjatë zhvillimit të tubimeve.
- Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë.
- Gjatë zhvillimit të fushatës elektorale, bashkëpunoni me të gjithë drejtuesit e

subjekteve elektorale që janë regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me programin (kalendarin) e aktiviteteve elektorale që do të zhvillojnë, kohën e zhvillimit të tyre, vendin dhe pjesëmarrësit e pritshëm që do të marrin pjesë në këto aktivitete elektorale, si dhe tu bëjë me dije detyrimin që kanë në bazë të ligjit.

1. Kujtesë mbi përmbajtjen e njoftimit të subjekteve elektorale.

- Në rast zhvillimi tubimi në sheshe ose vendkalime publike, duhet që ju të merrni dijeni me shkrim nga organizatori dhe drejtuesi i tubimit, jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit, me këtë përmbajtje;
 - Identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit;
 - Qëllimin e tubimit;
 - Datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij (nëse ka të tillë);

- Numrin e përafërt të pjesëmarrësve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit;
 - Personat që do të flasin në tubim.
-
- Kur njoftimi nuk i përmban elementet e mësipërm, ktheheni për plotësim organizatorit dhe drejtuesit të tubimit, të cilët duhet ta riparaqesin atë të plotësuar jo më vonë se 24 orë para kohës kur do të zhvillohet tubimi.
 - Kur ka rrethana urgjente, tubimi mund të zhvillohet pa respektuar afatet e mësipërme, po detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim i cili përmban elementet e përcaktuara me lart, si dhe arsyen e urgjencës. Njoftimi në komisariatit e policisë duhet të bëhet menjëherë, po jo më vonë se 3 orë përpara kohës së zhvillimit të tubimit.

2. Kujtesë për drejtuesit e komisariateve të policisë pas marrjes së njoftimit për zhvillimit e tubimit.

I nderuar koleg, kujtohu, mos harro!

Se, brenda 24 orëve, me vendim të arsyetuar duhet :

- T'i komunikoni organizatorit ose drejtuesit të tubimit ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij.
- T'i jepni një kopje të urdhrin zyrtar për caktimin e oficerit të policisë që do të jetë përgjegjës për të ndihmuar e vëzhguar zhvillimin e tubimit.
- Të njoftoni me shkrim drejtuesin e pushtetit vendor dhe Prefektin për zhvillimin e tubimit.

3. Kujtesë për drejtuesit e komisariateve të policisë para, gjatë dhe pas zhvillimit të tubimeve në sheshe ose vendkalime publike.

I nderuar koleg, kujtohu, mos harro!

- Të siguronit informacionin e nevojshëm për garantimin e rendit dhe sigurisë publike gjatë zhvillimit të tubimit konform procedurave standarde.
- Të zhvilloni një takim para fillimit të tubimit me drejtuesit, organizatorët e subjektit elektorale që zhvillojnë këtë tubim, si dhe të prezantoni oficerin e policisë përgjegjës për të ndihmuar e vëzhguar zhvillimin e tubimit.
- Të bashkëpunoni me drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore, drejtorive rajonale të shërbimit shëndetësor, shërbimin zjarrfikës etj, në funksion të mbarëvajtjes së tubimit.
- Të bashkëpunoni dhe koordinoni masat dhe veprimet me shërbimet e Gardës së Republikës në rastet kur në tubim do të marrin pjesë edhe Personalitetet e Larta Shtetërore.

- Të koordinoni masat dhe veprimet me forcat dhe shërbimet e tjera policore që u vihen në dispozicion.
 - Të hartoni e miratoni Planin e Veprimit (Masave) së bashku me Planin e të papriturave.
 - Të hartoni dhe miratoni Urdhrin e Shërbimit.
 - Të jepni udhëzimet e shërbimit.
-
- Të organizoni dhe drejtoni shërbimet për garantimin e rendit dhe sigurisë publike gjatë zhvillimit të tubimit.
 - Të bëni konkluzionet për shërbimin e kryer dhe të përcaktoni detyra për të ardhmen.

4. Kujtesë për punonjësit e policisë të caktuar me shërbim për garantimin e rendit dhe sigurisë publike gjatë zhvillimit të tubimit.

Punonjësi i policisë gjatë përmbushjes së detyrave për garantimin e rendit dhe sigurisë publike në tubime, duhet :

- Të njohë rolin e Tij në shërbim dhe të koordinojë me kolegët e tjerë për të përmbushur detyrat institucionale.
- Të reflektojë gatishmëri dhe dinjitet me pamjen dhe sjelljen e Tij.
- Të mbajë një qëndrim ligjor dhe të komunikojë në bazë të Kodit të Etikës së Policisë.
- Të përmbush detyrat me profesionalizëm dhe në bazë të procedurave standarde.
- Të ketë të qartë se nuk është detyra e punonjësve të policisë për të gjykuar çështjet që trajtohen në tubim. Kurrë mos diskutoni ose argumentoni çështjet e përfshira nga tubuesit.
- Të jetë i përgatitur për ti rezistuar abuzimit me gojë nga pjesëmarrësit në tubim me qëllimin për t'u tërhequr në një veprim jo të ligjshëm.

5. Kujtesë për rastet e ndalimit të zhvillimit të tubimit dhe shpërndarjen e tubimit.

Ndalimi i zhvillimit të një tubimi.

- Kur ka arsye të motivuar se zhvillimi i një tubimi në një shesh ose vendkalim publik përbën një rrezik real për sigurinë

kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të të tjerëve dhe ky rrezik nuk mund të ndalohet me masa më pak shtrënguese, shefi i komisarariatit të policisë mund të ndalojë zhvillimin e tubimit ose të vendosë për kohën dhe vendin e zhvillimit të tubimit.

Shpërndarja e tubimit.

- Një tubim në një shesh ose vendkalim publik mund të shpërndahet nga forcat policore me uniformë, vetëm në rastet kur :
 - ✓ mënyra e zhvillimit të tubimit është e tillë që mund të dëmtojë në mënyrë konkrete rendin publik dhe sigurinë e personave;
 - ✓ gjatë zhvillimit të tij kryhen krime;
 - ✓ ekziston një situatë emergjente që lidhet me sigurinë publike, kur vendi i zënë nga tubimi kërkohet nga shërbimet e emergjencës.
- Oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit, mund të urdhërojë largimin e

një grupi personash nga tubimi, në rast se mendon se rreziku shmangët me largimin e këtij grupi personash që pengojnë zhvillimin normal të tubimit. Në rast të kundërt, oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar tubimin, urdhëron organizatorët, drejtuesit dhe pjesëmarrësit të ndërpresin tubimin dhe të largohen nga vendi.

Ndalimi dhe mbyllja e tubimit.

- Mbatja e një tubimi në vende të hapura për publikun mund të ndaloher dhe të mbyllet, nëse ka filluar, kur:
 - ✓ organizatori, drejtuesi ose personat ndihmës lejojnë hyrjen e pjesëmarrësve të cilët mbajnë armë;
 - ✓ ka arsye të motivuara për të besuar se zhvillimi i tubimit do të bëhet i dhunshëm ose rebelues;
 - ✓ ekziston rrezik për jetën ose shëndetin e pjesëmarrësve.

6. Kujtesë për ndalimet gjatë zhvillimit të tubimeve.

Ndalimi i mbajtjes së armëve.

- Organizatori, drejtuesit, personat ndihmës dhe pjesëmarrësit në një tubim, kudo ku zhvillohet ai, nuk lejohen të mbajnë armë edhe nëse kanë lejë për mbajtjen e tyre.
- Organizatori, drejtuesit, personat ndihmës dhe pjesëmarrësit në një tubim ndalohen të mbajnë mjete ose instrumente të cilat gjatë përdorimit të tyre mund të shkaktojnë dëm për jetën dhe shëndetin e të tjerëve. Përfshihen nga ky detyrim flamujt dhe pankartat.

Ndalimi i fshehjes së identitetit.

- Ndalohet pjesëmarrja në tubim me veshje të tilla ose përdorimi i sendeve të tjera me qëllim fshehjen e identitetit të personit.

Ndalimi i përdorimit të uniformës, shenjave ose simboleve.

- Në tubime të zhvilluara në sheshe ose vendkalime publike ose në vende të

hapura për publikun, nga organizatori, drejtuesit, personat ndihmës dhe pjesëmarrësit, nuk lejohet përdorimi i uniformave, shenjave ose simboleve që u referohen shoqatave ose grupeve të cilat janë krijuar për të nxitur diskriminimin dhe dhunën për arsye raciale, etnike ose fetare.

7. Kujtesë për rastet e ndërhyrjeve të Policisë së Shtetit dhe saksionet.

Regjistrimi i zërave dhe figurave.

- Në tubimet në sheshe e vendkalime publike ose në vende të hapura për publikun, policia mund të regjistrojë zëra, të filmojë ose të fotoqafojë vetëm në rast se ka arsye për të besuar së ekziston një rrezik i menjëhershëm për rendin dhe sigurinë publike.
- Regjistrimet, filmimet dhe fotografitë duhet të asgjësohen menjëherë pas tubimit, në rast se nuk nevojiten:
 - ✓ për nisjen e procedimit penal të pjesëmarrësve;
 - ✓ për parandalim rreziku, kur besohet se personi i filmuar mund të kryejë

në të ardhmen vepra penale në lidhje me tubimet.

Përfundimi i pjesëmarrësve nga policia.

- Gjatë një tubimi, policia, me kërkesë të drejtuesit të tubimit ose kryesisht, mund të përfundojë pjesëmarrës ose grupe pjesëmarrësish nga tubimet e zhvilluara në sheshe dhe vendkalime publike, kur janë përgjegjës për sjelljen që ndalohet sipas nenit 8 të këtij ligji.
- Në këto raste policia mund të bëjë identifikimin e këtyre personave, kontrollin për armëmbajtje dhe u jep urdhër për largimin nga vendi ku zhvillohet tubimi.

Masat për shpërndarjen e një tubimi.

- Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë ligj, kur duhet bërë shpërndarja e një tubimi, oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit, i jep urdhër organizatorëve, drejtuesit, personave ndihmës dhe pjesëmarrësve të ndërpresin tubimin dhe të largohen menjëherë nga vendi i zhvillimit të tubimit.

- Në rast se pas tri thirrjeve të qarta nga ana e policisë për shpërndarje, pjesëmarrësit nuk largohen, oficeri i policisë urdhëron shpërndarjen e tubimit me forcë.
- Në çdo rast përdorimi i forcës duhet të kufizohet përherë në minimum.

Sanksionet.

- Pjesëmarrja nga personat në tubime të ndaluara për t'u zhvilluar, sipas nenit 8 të ligjit "Për Tubimet", dënohet, me gjobë nga 1000 deri në 10 000 lekë;
- Moszbatimi i urdhrave të policisë për shpërndarjen e tubimit sipas nenit 9 të ligjit, dënohet, me gjobë nga 1000 deri në 10 000 lekë;
- Përdorimi i veshjeve ose i sendeve të tjera me qëllim fshehjen e identitetit të personit gjatë zhvillimit të një tubimi, sipas nenit 19 ligji, dënohet, me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj;
- Përdorimi i shenjave ose simboleve që u referohen shoqatave ose grupeve të krijuara për të nxitur dhunën dhe diskriminimin për arsye raciale, etnike ose fetare, sipas nenit 20 të ligjit "Për

tubimet”, dënohet, me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.

I nderuar Koleg, kujtohu dhe mos harro se, Kodi Penal parashikon këto dispozita;

Neni 261.

- Kryerja e veprimeve për të penguar shtetasit për të ushtruar lirinë e shprehjes së mendimit, të grumbullimit apo manifestimit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj. Kur veprimet shoqërohen me përdorimin e dhunës fizike, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 262.

- Organizimi i grumbullimeve dhe i manifestimeve të personave në sheshe dhe vende të kalimit publik, pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta apo kur nga organizatorët shkelen kushtet e parashtruara në kërkesën për dhënie të lejes, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer

në një vit. Pjesëmarrja në një grumbullim apo manifestim të paligjshëm edhe pas paralajmërimit të bërë për shpërndarje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj. Po kjo vepër, e kryer më shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja të rënda, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 263.

- Organizimi i grumbullimeve dhe manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të personave të armatosur dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme e personave të armatosur përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 269.

- Pengimi me dhunë i veprimtarisë së ligjshme të partive, organizatave apo shoqatave politike përbën kundërvajtje

penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 274.

- Hedhja e gurëve apo sendeve të tjera në banesën e shtetasit, krijimi i zhurmave shqetësuese si, me anë të shkrepjes së armëve apo plasjeve të ndryshme, të përdorimit jashtë rregullave të sirenave të automjeteve, apo çdo lloj tjetër sjelljeje të papëlqyeshme, në rrugë, sheshe e vende publike, që cenojnë dukshëm qetësinë e moralin apo tregojnë mospërfillje të hapët për mjedisin, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 283.

- Vënia e pengesave dhe ndalimi me çdo mjet e mënyrë i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujor e ajror, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 325.

- Pengimi me anë të kanosjes, dhunës, apo me çdo mënyrë tjetër i subjekteve zgjedhore apo i kandidatëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin gjatë fushatës zgjedhore, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në tre vjet”.
- Detyrimi i shtetasve nën varësi administrative, kundër vullnetit të tyre apo nën kanosjen e përdorimit të masave administrative, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Neni 328/a.

- Detyrimi apo organizimi për të marrë pjesë në veprimtari elektorale të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në një vit”.

II. Kujtesë për detyrat e Policisë së Shtetit për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve zgjedhore dhe shoqërimin e materialeve zgjedhore.

**I nderuar Koleg,
kujtohu dhe mos harro!**

1. Para fillimit të shërbimit.

- Të hartoni Planin e Masave për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve zgjedhore dhe shoqërimin e materialeve të votimit.
- Të zhvilloni instruktazhin.
- Të pajisni personelin me;
 - ✓ armatim, pajisjet e tjera të nevojshme për shërbim,
 - ✓ dokumentin e identifikimit sipas formatit të miratuar nga KQZ,
 - ✓ fotokopje të formatit të miratuar nga KQZ për njoftimin e Policisë së Shtetit për ndërhyrje në QV, VNV,
 - ✓ fotokopje të formatit të miratuar nga KQZ për largimin e forcave të Policisë së Shtetit nga QV, VNV,
 - ✓ fotokopje të formatit të miratuar nga KQZ të proces verbalit të dorëzimit të KZAZ të materialeve të votimit.

- ✓ fotokopje model proces verbali të dorëzimit të Qendrës së Votimit.
- ✓ fotokopje model të raporteve të shërbimit.
- Të pajisni punonjësit e policisë me listën emërore të personave (punonjësve të policisë, drejtuesve të shërbimeve të policisë, drejtuesve të Komisionit të Qendrës së Votimit, KZAZ) që duhet të komunikojë gjatë kohës së shërbimit dhe numrat përkatës të telefonit.
- Të caktoni oficerin e policisë përgjegjës për secilin grup shërbimi.
- Të pajisni dhe vendosni në të gjithë mjetet e policisë të uniformuara dhe të pa uniformuara të mbishkrimit sipas formatit të miratuar nga KQZ.
- Të caktoni automjetin i cili do të jetë në dispozicion të secilit grup shërbimi, që do të shërbejë për dërgimin e punonjësve të policisë pranë Qendrave të Votimit, si dhe të caktoni drejtuesin e mjetit.
- Të rikujtoni detyrat e punonjësve të policisë për marrjen në ruajtje të Qendrave të Votimit.
- Të rikujtoni mënyrën e veprimit;

- ✓ Gjatë ndërhyrjes në QV, VNV për rivendosjen e rregullit apo rendit publik.
- ✓ Në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të ndryshme kriminale.
- ✓ Gjatë shoqërimit të materialeve të votimit nga Qendra e Votimit deri në KZAZ.
- ✓ Gjatë dorëzimit të materialeve të votimit në KZAZ dhe pas dorëzimit të tyre.
- Të caktoni mënyrën e komunikimit gjatë gjithë kohës së shërbimit.

2. Kujtesë për ndalimet gjatë procesit zgjedhor.

- Ndalohet përdorimi i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë dhe atyre Speciale në ruajtjen e objekteve zgjedhore.
- Asnjë person i armatosur nuk lejohet të qëndrojë në mjediset e qendrës së votimit. Përfshihen nga rregulli punonjësit e Policisë së Shtetit, kur janë në ushtrim të detyrës, në përputhje me nenin 109 të Kodit Zgjedhor.

- Ndalohet përdorimi i forcave të Policisë së Shtetit dhe atyre të Ushtrisë që mund të cenojnë vullnetin e zgjedhësve.
- Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe forcave të tjera të ushtrisë gjatë periudhës zgjedhore, përveçse me urdhër me shkrim të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Mbrojtjes, kur këto forca nevojiten për ruajtjen e objekteve të rëndësisë së veçantë, ose në zëvendësim të punonjësve të policisë së objekteve.
- Në rastet e planifikuara urdhri me shkrim i Ministrit i dërgohet KQZ 5 ditë para hyrjes në fuqi. Në rastet e veçanta kopja e urdhrit me shkrim dërgohet menjëherë në KQZ.
- Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet.
- Ndalohet gjatë gjithë periudhës zgjedhore, kryerja e ushtrimeve ose manovrave ushtarake jashtë reparteve ose vendeve të dislokimit nga forcat e ushtrisë.
- Ndalohet përdorimi apo pjesëmarrja e punonjësve ose strukturave të SHISH-it

në ngjarjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet apo në veprime që mund të ndikojnë në vullnetin e zgjedhësve.

3. Kujtesë për detyrimet që kanë drejtuesit e Policisë së Shtetit.

- Drejtori i Policisë së Qarkut për problemet që mund të lindin gjatë periudhës zgjedhore dhe që kanë të bëjnë me sjelljen dhe qëndrimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, të njoftojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

4. Kujtesë për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve zgjedhore.

- Selia e KZAZ-së, ruhet nga momenti kur në të mbërrinë materialet e votimit deri në datën e zgjedhjeve.
- Ruajtja do të bëhet prej orës 20.00 deri në orën 8.00 të ditës së nesërme. Pavarësisht nga ky përcaktim, punonjësi i Policisë së Shtetit, nuk e kryen shërbimin e ruajtjes së selisë së KZAZ-së gjatë kohës kur kjo e fundit është në punë.
- Shërbimi i ruajtjes në KZAZ fillon menjëherë me paraqitjen e kërkesës së

kryetarit të KZAZ-së. Kërkesa është me shkrim dhe i dërgohet për çdo rast, Shefit të Komisarariatit që mbulon Njësinë e Qeverisjes Vendore, ku është vendosur zyra e KZAZ-së.

- Në çdo rast, kërkesa i bëhet me dije Drejtorit të Policisë së Qarkut.
- Kryetari i KZAZ-së jo më vonë se 7 ditë përpara datës së zgjedhjeve, i dërgon njoftim me shkrim Shefit të Komisarariatit të Njësisë së Qeverisjes Vendore, ku ndodhet zyra e KZAZ-së.
- Njoftimi përmban vendndodhjen e KZAZ-së dhe orarin e punës.
- Policia organizon ruajtjen e Qendrave të Votimit gjatë natës, para ditës së votimit, duke filluar nga momenti kur në KQV mbërrijnë materialet zgjedhore, deri në momentin kur KQV-ja fillon veprimet paraprake për çeljen e votimit.
- Policia organizon ruajtjen e ambientit të Vendit të Numërimit të Votave, prej orës 18⁰⁰ të ditës së zgjedhjeve, deri në momentin e nxjerrjes së tabelave të rezultatit nga KZAZ-ja.
- Punonjësi i Policisë së Shtetit qëndron jashtë ambienteve të Vendit të

Numërimin të Votave, sipas caktimit të bërë nga KZAZ-ja.

5. Kujtesë për rastet kur punonjësi i policisë lejohet për tu futur në ambientet e VNV.

- Gjatë procesit të numërimit të votave kur KZAZ-ja, konstaton se në ambientin e VNV-së, janë të pranishëm dhe persona të tjerë, përveç atyre të parashikuar në nenin 121 të Kodit Zgjedhor, u kërkon atyre që të largohen. Në rast refuzimi merr vendim për njoftimin e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe mban shënim në librin e protokollit.
- Kur në Vendin e Numërimit të Votave rrezikohet rendi, KZAZ-ja me vendim thërret organet e Policisë së Shtetit.
- Vendimi për kërkimin e ndihmës për vendosjen e rendit, i paraqitet me shkrim organeve të Policisë së Shtetit, dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe të rrethanave.
- Me marrjen e vendimit Kryetari, zëvendëskryetari ose çdo anëtar i KZAZ-së thërret menjëherë Policinë, dhe

njofton KQZ-në për incidentin e ndodhur.

- Kur forcat e policisë paraqiten në Vendin e Numërimit të Votave, KZAZ-ja u dorëzon atyre menjëherë përpara ndërhyrjes, kopje të vendimit për thirrjen e policisë për të ndërhyrë, të firmosur dhe vulosur nga ky komision.
- Me rivendosjen e rendit në Vendin e Numërimit të Votave, KZAZ-ja me vendim u kërkon forcave të Policisë së Shtetit të largohen.

6. Kujtesë për rastet kur punonjësi i policisë lejohet të futet në ambientet e Qendrës së Votimit.

- Kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi ose zhvillimi i rregullt i votimit, KQV-ja, pasi ka vendosur pezullimin e votimit, merr vendim dhe njofton menjëherë organet e Policisë së Shtetit dhe KZAZ-në përkatëse.
- Vendimi për kërkimin e ndihmës për vendosjen e rendit, i paraqitet organeve të Policisë së Shtetit.
- Kur forcat e policisë paraqiten në Qendrën e Votimit, KQV-ja, u dorëzon atyre menjëherë përpara ndërhyrjes

- vendimin për thirrjen e policisë.
- Në këto raste, KQV-ja plotëson procesverbalin për pezullimin e votimit.
 - Kryetari ose çdo anëtar i KQV-së njofton menjëherë KZAZ-në për incidentin e ndodhur. KZAZ-ja është e detyruar të shënojë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së njoftimin dhe orën e marrjes së tij. KZAZ-ja ia përcjell kërkesën menjëherë organeve të Policisë së Shtetit.
 - Me rivendosjen e rendit në qendrën e votimit, KQV-ja, me vendim u kërkon organeve të Policisë së Shtetit të largohen nga qendra e votimit, dhe merr masa për rifillimin e menjëhershëm të votimit.

7. Kujtesë për veshjen, armatimin, lëvizjet dhe vendqëndrimin e policisë.

- Punonjësit e Policisë së Shtetit, të ngarkuara me detyra zgjedhore, janë të detyruar të mbajnë;
 - ✓ Uniformën.
 - ✓ Dokumentin e identifikimit sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

- ✓ Vetëm armatim personal brezi (pistoletë).
- ✓ Përveç armatimit personal të brezit dhe automatik në rastet kur ngarkohen me ruajtjen e objekteve zgjedhore gjatë natës dhe gjatë shoqërimit të kutive të votimit nga Qendra e Votimit në Vendin e Numërimit të Votave, me përjashtim të rastit kur janë ngarkuar të ruajnë godinën ku është caktuar Vendi i Numërimit të Votave.
- Qarkullimi i forcave të policisë, të ngarkuara me detyra zgjedhore, bëhet vetëm me mjete policie dhe vetëm në rast se kërkohet ndërhyrja e tyre respektivisht nga KQZ-ja, KZAZ-ja ose nga KQV-ja.
- Mjetet e përdorura prej policisë, me targa civile duhet të kenë shenja dalluese që tregojnë se ato janë të ngarkuar me detyra në funksion të zgjedhjeve. Targat civile dhe shenjat dalluese bëhen me dije në KQZ jo më vonë se 10 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.
- Punonjësit e forcave të policisë që ngarkohen me detyra gjatë zgjedhjeve,

me përjashtim të atyre që merren me ruajtjen objekteve zgjedhore, në 24 orët para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve, qëndrojnë brenda komisariateve ose në vende dislokimi larg qendrave të banuara.

- Asnjë person i armatosur, duke përfshirë edhe forcat e policisë dhe ushtarakët, nuk lejohet të qëndrojë apo të hyjë në ambientet zgjedhore, përjashtohen nga ky përcaktim, rastet kur prania e forcave të policisë kërkohet përkatësisht nga KZAZ-ja ose nga KQV-ja, si dhe në rastin e prezencës së punonjësve të policisë së burgjeve brenda territorit të burgut ose vendit të paraburgimit, ku është ngritur qendra e posaçme e votimit.

8. Kujtesë për shoqërimin e kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore.

- Me mbylljen e votimit, Kryetari i KQV-së njofton komisariatin e policisë dhe KZAZ-në duke i kërkuar të dërgojë në KQV punonjës të policisë i cili është efektiv i përhershëm i Policisë së Shtetit, përjashtuar policinë kriminale (Departamentin e Hetimit të Krimeve)

që do të shoqërojë kutitë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore.

- Punonjësi i policisë paraqitet në kohën e caktuar nga KQV-ja dhe pret në hyrje të saj, derisa të dalin anëtarët dhe sekretari së bashku me kutitë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore.
- Shoqërimi i kutive të votimit dhe i kutisë së materialeve zgjedhore nga KQV-ja në Vendin e Numërimit të Votave bëhet me automjet në të cilin ndodhen anëtarët e KQV-së, sekretari i KQV-së dhe një punonjës i Policisë së Shtetit.
- Gjatë shoqërimit, kutia dhe materialet e tjera zgjedhore, administrohen vetëm prej kryetarit, Sekretarit dhe anëtarëve të KQV-së. Punonjësi i forcave të policisë nuk ka të drejtë në asnjë rast, që të posedojë, apo të ketë kontakt, me materialet e mësipërme.
- Punonjësi i policisë, i ngarkuar me detyrën e shoqërimit të kutive të votimit dhe kutisë së materialeve zgjedhore nga Qendra e Votimit në Vendin e Numërimit të Votave, garanton shoqërimin dhe mosprekjen e kutive të votimit nga të tretët.

- Punonjësi i policisë i ngarkuar me shoqërimin e kutive të votimit, dhe kutive të materialeve zgjedhore, sipas pikës 3 dhe 4 të këtij neni, për çdo parregullsi të konstatuar gjatë procesit të shoqërimit nga KQV-ja në Vendin e Numërimit të Votave, përpilon një raport shërbimi, si dhe informon njëkohësisht eprorin e tij dhe ky i fundit njofton shefin e Komisarariatit të Policisë dhe KZAZ-në.
- Pas procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore, punonjësi i policisë firmos procesverbalin e marrjes në dorëzim, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja, merr një kopje të procesverbalit dhe largohet menjëherë nga ndërtesa e KZAZ-së.

9. Kujtesë për punonjësit e policisë gjatë kryerjes së detyrës për ruajtjen dhe sigurimin e Qendrës së Votimit, KZAZ, VNV.

**I nderuar Koleg,
kujtohu dhe mos harro!**

a) Gjatë kryerjes së detyrës për ruajtjen e objekteve zgjedhore.

- Prezantohu tek drejtuesit e QV, KZAZ në lidhje me detyrën që keni marrë.
- Kontrolllo gjendjen e objektit nga jashtë, dyert, dritaret, zgarat e hekurit etj.
- Mbaj në gatishmëri armatimin dhe pajisjet speciale të shërbimit.
- Kontrolllo mbylljen e derës së QV, KZAZ, VNV dhe vulosjen e saj nëse është vulosur, me përfundimin e punës dhe largimin nga ambienti të personave në përbërje të Komisionit përkatës.
- Raporto tek eprori mbi largimin e personave në përbërje të QV, KZAZ, VNV dhe fillimin e shërbimit.
- Mbaj në mbikëqyrje të vazhdueshme objektin dhe zbato procedurat standarde për të garantuar ruajtjen dhe sigurinë e tij.

- Komunikohet në vijimësi me eprorin direkt dhe shërbimin e sallës së drejtimit, koordinimit e emergjencës në komisariatit e policisë.
- Dorëzo me procesverbal objektin, Komisionit të QV, KZAZ.
- Raporto tek eprori mbi dorëzimin e objektit dhe vepra sipas urdhrave të tij.

b) Gjatë ndërhyrjes në ambientet e QV dhe VNV për rivendosjen e rregullit dhe të rendit publik.

- Kontakto menjëherë drejtuesit e QV, KZAZ, duke u njohur me situatën dhe vendimin për kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit publik.
- Vlerëso menjëherë situatën.
- Vepra në bazë të procedurave standarde për rivendosjen e rregullit apo rendit publik.
- Komunikohet me eprorin për situatën dhe në rast nevojë kërkohet ndihmën e nevojshme.
- Komunikohet me drejtuesit e QV dhe KZAZ, me rivendosjen e rregullit, rendit dhe

me marrjen e vendimit nga ana e tyre, largohu nga ambientet e QV dhe VNV.

- Raporto tek eprori për përfundimin e detyrës dhe vepro sipas udhëzimeve të tij.

c) Në rastet kur cenohet rendi dhe siguria publike në ambientet e jashtme të Vendit të Numërimit të Votave (VNV).

- Merrni të gjitha masat për organizimin e shërbimeve të nevojshme policore për menaxhimin e situatës së krijuar në ambientet e jashtme të VNV.
- Komunikoni menjëherë me drejtuesit e drejtorisë së policisë qarkut duke e informuar në lidhje me situatën e krijuar dhe masat që keni marrë.
- Vlerësoni në vijimësi situatën dhe në rast nevojë kërkoni ndihmë për forca shtesë më të specializuara.
- Bashkëpunoni me drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore dhe drejtuesit e KZAZ.
- Menaxhoni dhe drejtoni të gjithë shërbimet dhe strukturat e policisë në vartësi.

- Bashkëpunoni dhe koordinoni me organet e prokurorisë së rrethit gjyqësor për kryerjen e veprimeve procedurale.

I nderuar Koleg, kujtohu dhe mos harro se, Kodi Penal parashikon këto dispozita;

Neni 326

Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve.

Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, me qëllim ndryshmin e rezultatit të zgjedhjeve nëpërmjet paraqitjes në to të të dhënave, që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i të saktave me të rreme ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër kur kryhet nga personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor, ose ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit, ka cenuar integritetin e rezultatit të zgjedhjeve apo ka sjellë pavlefshmërinë e tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet dhe me

gjobë nga treqind mijë gjer në gjashtëqind mijë lekë.”.

Neni 326/a

Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor.

Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo material i tjetër zgjedhor të parashikuar nga ligji, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet.

Po këto vepra kur kryhen nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo kur kanë sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve, kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatin e votimit, dënohen me burgim nga tre gjer në tetë vjet dhe me gjobë nga dyqind mijë gjer në shtatëqind mijë lekë.”.

Neni 327

Shkelja e fshehtësisë së votimit

Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e personave të ngarkuar me zgjedhjet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet”.

Neni 327/a

Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar

Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje, votimi për persona të tjerë, duke paraqitur dokumente identifikimi të rreme apo duke përdorur dokumente të zgjedhësve të tjerë dënohet me burgim nga një gjer në tre vjet.

Lejimi me dashje i kryerjes së kësaj vepre nga komisionarët zgjedhorë dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Lejimi me dashje nga komisionarët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në një vit”.

Neni 328

Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve Ofrimi ose dhënia e të hollave apo të mirave materiale, bërja e premtimeve për vende pune ose për favorizime të tjera në cilëndo formë, me qëllim që të marrë firmën për paraqitjen e kandidatit, për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje

penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në dy vjet.

Pranimi i të hollave, të mirave materiale, premtimeve dhe favorizimeve të tjera kundrejt kryerjes së veprimeve të mësipërme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.”.

Neni 328/a

Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike

Detyrimi i shtetasve nën varësi administrative, kundër vullnetit të tyre apo nën kanosjen e përdorimit të masave administrative, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Detyrimi apo organizimi për të marrë pjesë në veprimtari elektorale të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në një vit.”.

Neni 329

Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje.

Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet nga tre muaj gjer në dy vjet.

Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.”.

Neni 330

Pengimi i zgjedhësit

Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit, duke shkelur rregullat e votimit, duke i marrë apo dëmtuar dokumentin e tij të identifikimit, apo në çdo formë tjetër, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në një vit.

Kur kjo vepër kryhet më shumë se një herë, ndaj më shumë se një zgjedhësi apo kur kryhet nga komisionerët zgjedhorë, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.”.

Neni 330/a

Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve.

Braktisja e detyrës apo refuzimi për të kryer detyrën nga personat e ngarkuar me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në dy vjet.

Kur veprimet e mësipërme kryhen duke marrë me vete ose duke zhdukur materialet zgjedhore, ose kur kanë sjellë pasoja të rënda për procesin e votimit apo kanë çuar në pavlefshmërinë e zgjedhjeve, dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.”.

Neni 331

Shkelja e së drejtës së zgjedhjes

Mospërfshirja me dashje në listat e zgjedhësve e personave që e kanë të drejtën e zgjedhjes ose regjistrimi me dashje në to i personave që nuk e kanë

këtë të drejtë, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër e kryer në bashkëpunim, kur ka sjellë pasoja të rënda për interesat e zgjedhësve apo mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë gjer në shtatëqind mijë lekë.”.

III. Kujtesë për detyrat e Policisë së Shtetit për hetimin, dokumentimin e veprave penale.

1. Për hetimin dhe dokumentimin e veprave penale.

- Caktoni dhe mbani në gatishmëri personelin përgjegjës në përbërje të grupit të hetimit.
- Merrni masa për sigurimin e plotë të vendit të ngjarjes.
- Njoftoni menjëherë prokurorin e gatshëm.
- Grumbulloni informacionin e duhur për identifikimin dhe kapjen e autorëve.
- Mbështetni grupin e hetimit me mjetet e duhura logjistike.

- Vihuni në dispozicion të prokurorit dhe zbatoni detyrat e deleguara prej tij.
- Vlerësoni situatën dhe në rast nevojë mbështesni me forca shtesë grupin hetimor.
- Dërgoni në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit informacionin e saktë, qartë dhe të plotë për ngjarjen e ndodhur.
- Përgatisni njoftimin për median.

Përgatiten Manualin;

- Zëvendës drejtori i Përgjithshëm për Sigurinë Publike Muhamet Rrumbullaku
- Drejtori Rendit Publik Drejtues i Parë Ilia Nasi
- Shefi i Sektorit Rendit Publik Drejtues Bedri Dani
- Shefi i Sektorit Analizës së Riskut Drejtues Zef Laska
- Specialist në Sektorin e Analizës së Riskut Kryekomisar Adriatik Ago
- Specialist në Sektorin e Rendit Publik Kryekomisar Pandeli Sullaj

IV. Modelarë aktesh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së
Shtetit

Drejtoria e Policisë se Qarkut

Komisariati i Policisë _____

Nr. _____ prot.
Tiranë, më ____ . ____ .2013

PROCES - VERBAL

Mbi

DORËZIMIN E QENDRËS SË VOTIMIT

Nr. _____.

Kryetari i Qendrës së Votimit
Sekretari i Qendrës së Votimit

(_____)
(_____)

Punonjesi i Policise Rendit
(_____)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME


Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së
Shtetit
Drejtoria e Policisë së Qarkut

Komisariati i Policisë _____

Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____._____.2013

RAPORT - SHËRBIMI

Në _____, sot më datën
_____._____. 2013, Unë / Ne punonjësit e
Policisë së Rendit të Komisarariatit të Policisë
Nr._____, duke qënë me shërbim, të
dislokuar nga ora _____ deri në orën
_____, në zbatim të Nenit _____ të
Kodit Zgjedhor, ruajtja e rendit në qendrat
e votimit Nr._____, rreth orës_____.



Përpilohet ky raport shërbimi për efekt pune.

Perpiluesit e Raportit te Sherbimit

1. (_____)

2.(_____)

3.(_____)

4. (_____)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KZAZ NR. _____, QARKU _____
KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT NR. _____

MODEL - 05 KQV

VENDIM

Nr. _____, datë 23.06.2013

**PËR KËRKIMIN E NDIHMËS NGA POLICIA E SHTETIT PËR
RIVENDOSJEN E RENDIT NË QENDRËN E VOTIMIT**

Komisioni i Qendrës së Votimit Nr. _____ i KZAZ-së Nr. _____, Qarku _____, i mbledhur sot në datë 23.06.2013, ora _____, meqenëse vazhdon të rrezikohet rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit, bazuar në nenin 42 pika 4 gërma c dhe nenin 109, pika 3 dhe 4, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të kërkojë sot në datën 23.06.2013, ora _____ ndihmën e Policisë së Shtetit për rivendosjen e rendit në Qendrën e Votimit.
2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë KZAZ-së Nr. _____, Qarku _____

Komisioni i Qendrës së Votimit Nr. _____

	Pro/kundër	Firma
1. _____ Kryetar	_____	_____
2. _____ Sekretar	_____	_____
3. _____ Anëtar	_____	_____
4. _____ Anëtar	_____	_____
5. _____ Anëtar	_____	_____
6. _____ Anëtar	_____	_____
7. _____ Anëtar	_____	_____

Vendime të Komisionit të Qendrës së Votimit

Adresa:
Pallati i Kongresit,
Blvd. Dëshmorëve e Shqipërisë,
Tirana.

Tel./Fax:
+355 (0) 23 53 42

Website: www.ncz.org.al

E-mail:
info@ncz.org.al



VULA



Vendime të Komisionit të Qendrës së Votimit

Adresë:
Palati i Kongresit,
Bld. Dëshmorët e Kombit,
Tiranë,
Shqipëri
Tel./fax:
+355 (4) 22 53 62
Webste: www.cnc.org.al
E-mail:
info@cnc.org.al



MODEL – 06 KQV

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KZAZ NR. _____, QARKU _____
KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT NR. _____

VENDIM

Nr. _____, datë 23.06.2013

**PËR LARGIMIN NGA QENDRA E VOTIMIT TË FORCAVE
TË POLICISË SË SHQIPËRISË**

Komisioni i Qendrës së Votimit Nr. _____ i KZAZ-së Nr. _____, Qarku _____, i mbledhur sot në datë 23.06.2013, ora _____, pasi konstatoi rivendosjen e rendit në Qendrën e Votimit, bazuar në nenin 42, pika 4 gërma ç dhe nenin 109, pika 5 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. T'u kërkojë punonjësit/punonjësve të Policisë së Shtetit largimin nga Qendra e Votimit.
2. Të rifillojë menjëherë procesin e votimit.
3. Ky vendim ti njoftohet menjëherë KZAZ-së Nr. _____, Qarku _____.

Komisioni i Qendrës së Votimit Nr. _____

	Pro/kundër	Firma
1. _____ Kryetar	_____	_____
2. _____ Sekretar	_____	_____
3. _____ Anëtar	_____	_____
4. _____ Anëtar	_____	_____
5. _____ Anëtar	_____	_____
6. _____ Anëtar	_____	_____
7. _____ Anëtar	_____	_____

VULA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR. _____
QARKU _____

MODEL - 32 V

VENDIM

Nr. _____, datë _____, 2013

PËR NJOFTIMIN E POLICISË SË SHTETIT

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor Qarku _____, sot në orën _____, duke qenë se në ambientin e VNV-së ndodhen persona të paautorizuar dhe/ose rrezikohet rendi, bazuar në nenin 121, pika 2, të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", si dhe Udhëzimin nr.7, datë 23.03.2009 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë në zgjedhjet për Kuvendin 2009", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të njoftojë sot në datën _____, 2013 ora _____ forcat e Policisë së Shtetit për nxjerrjen e personave të paautorizuar dhe/ose rivendosijen e rendit në Vendin e Numërimit të Votave.
2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë KQZ-së.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor NR. _____
Qarku _____

	Pro/kundër	Firma
1. _____ Kryetar	_____	_____
2. _____ Zv/kryetar	_____	_____
3. _____ Anëtar	_____	_____
4. _____ Anëtar	_____	_____
5. _____ Anëtar	_____	_____
6. _____ Anëtar	_____	_____
7. _____ Anëtar	_____	_____

Vendime të KZAZ-së
Zgjedhjet për Kuvendin 2013

Adresa:
Palati i Kongresit,
Blvd. Dëshmorët e Kombit,
Tiranë.

Tel./Faks:
+355 (0) 22 53 53 42

Website: www.csk.org.al

E-mail:
csk@csk.org.al



VULA



PV-KZAZ-09

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

Për dorëzimin në KZAZ nga KQV-ja të materialeve zgjedhore për zgjedhjet Kuvendin e Shqipërisë të datës : 23 Qershor 2013
Baza ligjore: neni 115 pika 2, 3, 4, 7, 8, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 " Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ", i ndryshuar

KZAZ:	
KQV Nr:	

Qarku:	
Datë:	

KUJDESI! Ky procesverbal mbahet në 4 (katër) kopje. KZAZ është e detyruar që të dorëzojë faqen e parë origjinale në KQZ, Kopjen e 2-të e mban KZAZ-ja, kopje e 3-të i jepet KQV-së dhe një kopje e marr punonjësi i Policisë së Shtetit.

1. Kuti Votimi me nr. të vulave të sigurisë: (kuta e votimit duhet të jetë e vulosur me 5 vula (kode))				
1.1 Kjo kuti votimi është:		1.2. Nëse kutia e votimit është e parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara:		
a. e rregullt <input type="checkbox"/>	b. e parregullt <input type="checkbox"/>			
KUTIA E VOTIMIT ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË:				
1)	2)	3)	4)	5)
2. Kuti e Materialeve Zgjedhore me nr. të vulave (kodeve) të sigurisë: (duhet të jetë e vulosur me 4 vula/kode)				
2.1 kutia e materialeve zgjedhore është:		2.2. Nëse kutia e votimit është e parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara:		
a. e rregullt <input type="checkbox"/>	b. e parregullt <input type="checkbox"/>			
KUTIA E MATERIALEVE ZGJEDHORE ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË:				
1)	2)	3)	4)	
3. VULA REZERVË TË PAPËRDORURA:				
1)	2)	3)		
4.	Koha e marrjes në dorëzim :	Datë	/ / 2013	Ora : ____ : ____

Punonjësi i Policisë së Shtetit:	Dorëtimi nga: KQV nr. _____	Marrësi në dorëzim nga Anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim:
	Kryetar: _____ <small>(emri, mbiemri, emë)</small>	Anëtar: _____ <small>(emri, mbiemri, emë)</small>
	Zv.Kryetar: _____ <small>(emri, mbiemri, emë)</small>	Anëtar: _____ <small>(emri, mbiemri, emë)</small>
	Sekretar: _____ <small>(emri, mbiemri, emë)</small>	VULA Sekretar: _____ <small>(emri, mbiemri, emë)</small>

Shënim: Materialet të cilat duhen kthyer në KZAZ dhe më pas në KQZ, janë të identizuara dhe moskthimi i tyre ju ngarkon me përgjegjësi financiare, kundrejt vlerës të pa-dorëzuar në KQZ.

PV-KZAZ-09 - i miratuar me Vendimin nr 0, datë 10.01.2013, të KQZ-së

Numra telefoni të rëndësishëm